



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.784/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri, Ilir Krasniqi nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar apeli i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri, Ilir Krasniqi nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Vushtrri.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë dega në Vushtrri në Vendvotimet: 2702B/01R dhe 2727B/02D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 09.11.2017 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Vushtrri, Ilir Krasniqi nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se në fshatin Dumnicë të Vushtrris, në vendvotimin 2702B/01R dhe në Shtitaricë të Vushtrrisë në vendvotimin 2727B/02D, në FPR nuk ka pasur vota por votuesi deklaroi se ka vota.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur deklaratën e Ajet Beka.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të sigurtë ka vërtetuar se vërtetuar mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

PZAP-i vendimin e vet e bazon në dispozitën nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, nga si u tha mësipër në mbështetje të nenit 117.4, 115.1 dhe 118.1 e LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 784/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa